

LIGJ
Nr. 23/2017

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES SË HUAS DHE PROJEKTIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCAVE, E OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA, SI AGJENCIA E
ZBATIMIT TË PROJEKTIT, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT “LINJA UNAZORE 110 KILOVOLT E SHQIPËRISË SË JUGUT”,
NËPËRMJET NJË HUAJE PREJ 37 750 000 EUROSH, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN
NR. 10 249, DATË 11.3.2010**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, dhe nenit 17, të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi i marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut”, nëpërmjet një huaje prej 37 750 000 eurosh, të ratifikuar me ligjin nr. 10 249, datë 11.3.2010, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.3.2017

Shpallur me dekretin nr. 10077, datë 13.3.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

KfW Bankengruppe, Postfach 111141, 60046 Frankfurt am Main

Operatori i Sistemit të Transmetimit

Drejtuar: z. Engjell Zeqo

Tiranë, Shqipëri

Ministria e Financave

Drejtuar Ministrit

Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të:

Ministrit të Energjisë dhe Industrisë së Shqipërisë

Drejtuar: Ministrit

Tiranë, Shqipëri

Bashkëpunimi Financiar i Qeverisë Gjermane me Qeverinë
Shqiptare për zgjatjen e afatit të disbursimit për linjën unazore
110 kV të Shqipërisë së jugut

Datë: 8 shtator 2016

KfW Development Bank

Marrëveshje Projekti dhe huaje:

Data: 4 janar 2010

Shuma: 37,750,000.00 euro

BMZ-Nr. 2008 65 188

Nr. i llogarisë së huas 6672705

Peter Ley

Ref. jonë: PeLe

Tel: +4969 7431- 3412

Faks: +4969 7431-3490

Peter.Ley@Kfw.de

Marrëveshja

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Marrëveshjes së lartpërmendur, kërkesës suaj të datës 6 shtator 2016, për një zgjatje të afatit të disbursimit. Kemi kënaqësinë t'iu informojmë se mund të përmbushim kërkesën tuaj dhe kemi marrë aprovimin e brendshëm që kostot e financimit të mos ua ngarkojmë juve, por t'i mbulojmë ne.

Me qëllim zbatimin e aktiviteteve të fundit të projektit, siç është ndërtimi i N/stacioneve 110-kV Orikum dhe Himarë, jemi dakord me ndryshimet e mëposhtme të Marrëveshjes:

Seksioni A- Ndryshimi i Marrëveshjes:

Marrëveshja (BMZ-nr. 2006 65 188) do të ndryshohet si më poshtë:

Neni 3.2: Afati për të kërkuar disbursim do të fshihet dhe zëvendësohet nga si më poshtë:

“KfW-ja mund të refuzojë disbursimet pas 30 qershorit 2018. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja mund të zgjasë afatin duke njoftuar Huamarrësin, sipas gjykimit të saj.”

Neni 13.2: Adresat e palëve kontratuale. Adresa e Huamarrësit ndryshohet si më poshtë:

“Për Huamarrësin:

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e

Kombit”, nr. 3

Tiranë

Shqipëri

Tel: +355 4 2228405

Fax: +355 4 2228494”

Seksioni B – Dispozita të tjera:

1. Kjo letër nuk ndryshon ose heq dorë nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshjeje kredie (huaje), përveç siç është përcaktuar shprehimisht në këtë letër.

2. Dispozitat e nenit 10 (Kostot dhe tarifat publike), nenit 11.5 (Përputhshmëria) dhe nenit 13.2 (Adresat), nenit 14.3 (Pavlefshmëria e pjesshme dhe mangësitë) dhe nenit 14.4 (Forma e shkruar dhe amendamenti), nenit 14.6 (Ligji i zbatueshëm) dhe nenit 14.9 (Mosmarrëveshjet ligjore – arbitrazhi) të Marrëveshjes, do të përfshihen në këtë letër, siç janë përcaktuar në mënyrë të plotë në të dhe siç referencat në këto dispozita të Marrëveshjes janë referenca në këtë letër.

Ju lutem, konfirmoni miratimin tuaj për ndryshimin dhe dispozitat shtesë të përcaktuara më sipër, duke nënshkruar në një formë ligjërisht të detyrueshme dhe duke na kthyer një kopje sa më shpejt të jetë e mundur.

Me respekt,

KfW
Jürgen Kern
Drejtues Divizioni

Peter Ley
Menaxher Projekti

Lexuar dhe nënshkruar:

Tiranë2016

.....

Për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Emri:

Titulli: